



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:015174  
Datë: 29.04.2024  
Numri i dokumentit: 05633892

CAP.nr.686/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Civil, nga gjyqtarja individuale Naime Ahmeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike, Sh.A (Kesco) me seli në Prishtinë, Bulevardi ‘‘Bill Clinton’’, nr.5 – Ndërtesa Elektro Kosova, kati VII, kundër debitorit R.I. nga Vushtrria, Rr.‘‘Lumni Surdulli’’, me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtri, CPP.nr.06/2023, të datës 12.04.2023, jashtë seance me datë 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet e themeltë ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KESco), me seli në Prishtinë, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtri, CPP.nr.06/2023, të datës 12.04.2023 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktvendimin e atakuar CPP.nr.06/2023, të datës 12.04.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit R.I. nga Vushtrria, Rr.‘‘Lumni Surdulli’’, dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.1670/22 i datës 14.12.2022, i lejuar nga përmbartuesi privat Atip Mustafa në territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtri.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, të aprovoj si të bazuar ankesën e kreditorit ashtu që të ndryshohet aktvendimi i atakuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbartim i përmbartuesit

privat ose të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, ashtu që në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

-Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit të verifikuar nga librat afariste për pagesën e shërbimeve komunale për konsumimin e energjisë elektrike DMI-..., lidhur me borxhin në vlerë prej 520.01 euro, për periudhën kohore nga data 19.08.2020 e deri me datën 16.11.2022. Përmbartuesi privat, ka lejuar përmbartimin e kërkuar me urdhrin përmbartimor P.nr.1670/22 të datës 14.12.2022. Kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datën 27.12.2022, ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim me datë 05.01.2023. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale respektivisht nenit 69 par.4 të LPP-së.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, kur ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe duke e shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.1670/22 i datës 14.12.2022. Gjykata e Apelit nuk mund ta pranojë këtë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë, për faktin se nuk mund të kuptohet se si ka ardhur deri te një vendosje e tillë me të cilin gjykata ka konstatuar se borxhi i kërkuar nga kreditori për periudhën e cekur si në propozimin për përmbartim në shumë prej 520.01 euro, është i paargumentuar dhe i pambështetur në provat që gjenden në shkresat lëndës, kur vetë konstaton se nga ekstrakti për të njëjtën periudhë borxhi i krijuar nga debitori është në shumë prej 517.72 euro, dhe jo detyrimi siç është kërkuar nga kreditori në propozimin për përmbartim. Ndërsa që edhe konstatimi tjetër i gjykatës se debitori ka paguar më shumë borxh se sa kërkuar kreditori me propozim duke u bazuar ekskluzivisht vetëm në ekstraktin e paraqitur nga kreditori dhe jo në ndonjë provë të ofruar nga debitori, është i pa mbështetur në prova dhe i paargumentuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se në bazë të nenit 69, paragrafi 4, të LPP-së, përcaktohet se: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet në prova të duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*. Në kuptim të kësaj dispozite ligjore Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është jo i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që nga shkresat e lëndës shihet se kreditori propozim për përmbartim pranë përmbartuesit privat e ka paraqitur me datën 14.12.2022, ndërsa borxhi i kërkuar me

propozim i përket periudhës nga data 19.08.2020 deri me datën 16.11.2022, sipas ekstraktit të verifikuar nga librat afarist ndaj debitorit me numër të konsumatorit DMI-..., për borxhin në shumë prej 520.01 euro, ndaj në këtë raste urdhri i ka plotësuar kushtet nga nenin 29 paragrafi 1, pika 1.2, lidhur me nenin 27 paragrafi 1, të LPP-së, për tu konsideruar dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbartim, sepse në dokumentin përmbartimor është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit, ndaj në rastin konkret nëse gjykata ka pasur dilema rreth shumës së borxhit është dashtë që ta ftoj kreditorin që ta precizoj shumën e borxhit, por se në gjë të tillë do të mund ta bënte vetëm nëse debitori do të kishte ofruar prova me prapësimin e ushtruar për shumën e borxhit të shlyer, që në rastin konkret prova të tilla nuk ka pasur, me çka nga këto arsye është dashur që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja ti kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

Në ri procedurë gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh vërejtjet e cituara me lartë, të vlerësoj dokumentin e besueshëm duke vlerësuar nëse borxhi i krijuar korrespondon me borxhin e kërkuar, nëse këto nuk mund t'i konstatoj të hap seancë dëgjimore dhe të ftoj palët, të cilët pretendimet e tyre të paraqitura në prapësim dhe përgjigje në prapësim do t'i argumentonin me prova konkrete e pas kësaj të vazhdoj procedurën konform dispozitave ligjore duke marr aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.686/2023, më datë 29.04.2024

Gjyqtarja  
Naime Ahmeti